



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3, Tiranë; E-mail: klsh.org.al; Web-site: www.klsh.org.al

Nr. 544/ 7Prot.

Tiranë, më 30/11/2017

V E N D I M

Nr.164, Datë 30/11/2017

PËR
AUDITIMIN E USHTRUAR
NË BASHKINË DROPULL DHE 3 ISH-KOMUNAT; DROPULL I SIPËRM,
DROPULL I POSHTËM DHE POGON ME OBJEKT "DHËNIEN E NJË
VLERËSIMI OBJEKTIV, PROFESIONAL E TË PAVARUR, MBI
SHKALLËN E ZBATIMIT NGA SUBJEKTI I AUDITUAR TË LIGJEVE
DHE RREGULLOREVE, POLITIKAVE, KODEVE TË VENDOSURA APO
TERMAVE DHE KUSHTEVE"

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*",

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit mbi "Dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e zbatimit nga subjekti i audituar të ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve" të ushtruar në Bashkinë Dropull sipas programit të auditimit nr.544/1, datë 16.05.2017 për periudhën nga data 01.08.2015 deri 31.12.2016 dhe 3 ish-Komunat; Dropull i Sipërm, Dropull i Poshtëm dhe Pogon, për periudhën nga data 01.01.2013 deri 31.07.2015.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASAT ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ushtruar në procedurat e prokurimit të realizuara për periudhën nën auditim, u konstatuan mangësi në drejtim të llogaritjes së fondit limit veçanërisht në prokurimin me objekt “Blerje karburanti”. Në argumentimin e fondit limit nuk është mbajtur parasysh çmimi sipas Bursës Reuters, për rrjedhojë fondi limit nga 3,210,660 lekë pa TVSH që duhej të ishte, në fakt është përcaktuar 4,060,000 lekë pa TVSH, ose **849,340 lekë** më tepër.

1.1. Rekomandimi: Në llogaritjen e fondit limit për prokurimin e blerjes së karburantit të merret për bazë çmimi sipas Bursës Reuters në momentin e zhvillimit të prokurimit, të bëhet hulumtimi i tregut për përcaktimin e një marzhi fitimi mesatar dhe të argumentohen me volume pune të mjeteve sasia e karburantit që do planifikohet.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ushtruar u konstatuan mangësi në drejtim të klasifikimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në tender. Kjo mangësi është shoqëruar në disa raste me kualifikim jo të drejtë të operatorëve ekonomik të shpallur fitues, pasi ofertat e paraqitura në formatin elektronik rezultuan me mangësi dhe si rrjedhojë operatorët ekonomik duhej të ishin s’kualifikuar. Kjo problematikë u ndesh tek operatorët ekonomikë si më poshtë:

- Shoqëria “T...” sh.p.k. në tenderin “Masa mbrojtëse hidroteknike te ura e fshatit Likomil”.

- Shoqëria “A...” sh.p.k. në tenderin “Ujësjellësi i jashtëm i Dropullit nga burimi i Manxifes”.

- Shoqëria “O...” sh.p.k. me tender “Rikonstrukcion rruga e brendshme Sopik”

Shoqëria “T...” sh.p.k. në tenderin “Kanali ushqyes i rezervuarit të Pepelit Gjirokastër dhe pastrim kanali vaditës i Pepelit nga pecalludha, deri në repartin Bularat 4200”.

2.1. Rekomandimi: Për kualifikimin e operatorëve ekonomikë konkurrentë në tender, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të zbatojë me korrektësi kërkesat për kualifikim të përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit nga Njësia e Prokurimit, duke zbatuar parimin e barazisë në tender për të gjithë konkurrentët.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Dosjet teknike të investimeve të cilat u audituan rezultuan me mangësi në dokumentacion, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit””, pika 4, paragrafi 4.

3.1. Rekomandimi: Bashkia Dropull, nëpërmjet Zyrës së Planifikimit të Territorit, të marrë masa për plotësimin e dokumentacionit të dosjeve teknike të investimeve gjatë procesit të zbatimit të kontratave deri në dorëzimin e objektit.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i taksave dhe tarifave vendore rezultoi se, për vitin 2015, programimi i të ardhurave nga tatimet taksat dhe tarifave vendorë, është miratuar në vlerën 27,928 mijë lekë, realizuar në fakt në vlerën 31,861 mijë lekë, me tejkalim në vlerën 3,933 mijë lekë, ose 114%. Për vitin 2016, programi i të ardhurave nga tatimet taksat dhe tarifave vendorë, është miratuar në vlerën 48,391 mijë lekë, realizuar në fakt në vlerën 50,586 mijë lekë me tejkalim në vlerën 2,194 mijë lekë, ose 104%.

Megjithëse janë aplikuar masat shtrënguese për arkëtimin e detyrimeve, u konstatua se nuk janë arkëtuar detyrimet për taksën e tokës bujqësore, në vlerën **2,472,737 lekë të ardhurat e**

munguara, në shkelje të ligjit nr. 9920, datë 19.04.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

4.1.Rekomandimi: Zyra e Taksave dhe Drejtoria e Financës Bashkia Dropull, të marrë masa për kryerjen e akt rakordimeve për debitorët e taksave për periudhën 01.01.2016 deri më datën 31.12.2016 dhe pasqyrimin në kontabilitet të debitorëve për taksën e tokës bujqësore, në vlerën **2,472,737 lekë**.

Për të gjitha detyrimet tatimore të pambledhura, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, nga Zyra e Taksave Bashkia Dropull të nxirren njoftim vlerësimit tatimore duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a-T’u dërgohen bankave urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

b-T’i dërgohen Drejtorisë Rajonale të Transportit, kërkesat për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

c- Për subjektet të cilët nuk kanë paguar detyrimet tatimore në afat, ndaj tyre të llogariten kamat vonesat, në masën 0,06% kamat vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë (gjobë) bazuar në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat tatimore në R.SH”, të ndryshuar, me ligjin nr. 164/2014 datë 15.12.2014.

d- Për subjektet që nuk pranojnë të paguajnë detyrimet në vite, nga ana e Bashkisë Dropull, Zyra e Taksave dhe Drejtoria Juridike, të marrë masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhej kallëzim penal sipas nenit 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008” ndryshuar me ligjin nr. 164/2014, datë 4.12.2014.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi:

a) Nga Bashkia Dropull dhe ish Komunitat Dropull i Poshtëm, Dropull i Sipërm nuk është vepruar, për të lidhur kontratë qiraje me subjektet private të cilat janë pajisur me leje minerare, të miratuara nga Ministria e Energjetikës dhe Industrisë, për shfrytëzimin e 22,21 ha të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore për qëllime biznesi, në bazë të tarifave të përcaktuara në VKM nr. 391, datë 21.06.2006, të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, lidhja nr. 2, pikat 6, 11 dhe 12, rezulton e pa arkëtuar vlera **37,329,600 lekë**, për 7 subjekte, efekt financiar negativ, të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Dropull.

b) Në Bashkinë Dropull, u konstatua se nuk janë zbatuar procedurat e pakësimit të sipërfaqes së fondit pyjor/kullosor, për subjektet e pajisura me leje minerare apo koncesionare, për pasojë nuk janë lidhur kontrata dypalëshe, siç përcaktohet në nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 “Për Fondin Kullosor”, pikat 3, 7, 7, 9, 10, 11 dhe 12, VKM nr. 1353, datë 10.10. 2008 “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, i ndryshuar me VKM nr. 434, datë 08.06.2016, VKM nr. 1374, datë 10.10. 2008 “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor”, i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2016.

5.1. Rekomandimi:

a. Bashkia Dropull, nëpërmjet strukturave të saj dhe zyra e administrimit të pyjeve e kullotave, të marrë masapër lidhjen e kontratave të qirasë duke vendosur edhe penalitetet përkatëse, me subjektet e pajisur me leje minerare të kërkojë arkëtimin e të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë, sipas aneksit 9/3 bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit. VKM 1353, datë 10.10.2008 “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, i ndryshuar me VKM nr. 434, datë 08.06.2016, VKM nr. 1374, datë 10.10. 2008 “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor” i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2016.

b. Struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në Bashkinë Dropull, t’i kërkojë Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit, që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullosor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore të mbetura.

c. Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t’i kërkohej Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme dhe kryerjen e pagesës së detyrimeve nga dëmtimi i fondit pyjor/kullosor.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi:

a) Nga ish Komunitat Dropull i Sipërm, Dropull i Poshtëm dhe Pogon, nuk është ngritur komision për të kryer inventarizimin kontabël dhe fizik të aseteve, nuk është kryer kolaudimi, vlerësimi, nuk është aplikuar në ZVRPP Gjirokastër për regjistrimin e tyre, sipas listave të VKM, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, me pikat 20, 21 dhe 22, të VKM nr. 500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, me pikat 37, 42-60, 74, të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

b) Nga ish Komunitat Dropull i Sipërm, Dropull i Poshtëm dhe Pogon, nuk është vepruar për marrjen në dorëzim të aseteve të qëndrueshme me procesverbal të nënshkruara nga përfituesi Bashkia Dropull dhe nga institucionet qendrore si dorëzues të aseteve, institucione këto, në pronësi të cilave kanë qenë pronat dhe asetet, sipas fushave përkatëse të përdorimit të pronës. Kalimi i pronave do të duhej të ishte shoqëruar me harta, të dhëna mbi infrastrukturën, sipërfaqen, gjendjen reale të tyre, etj, sipas listave të VKM, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet dhe kërkesat e VKM nr. 500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”.

c) Nga ish Komunitat Dropull i Sipërm, Dropull i Poshtëm dhe Pogon, nuk është hapur regjistri kontabël i aktiveve, nga nëpunësi autorizues, ish Titullari, Kryetari i Komunës, nuk ka caktuar nëpunësin zbatues për krijimin dhe mbajtjen e regjistrimit kontabël të gjithë aktiveve, që zotëron apo kanë në administrim Komunitat, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitullin III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 26 dhe 27.

6.1. Rekomandimi: Bashkia Dropull të marrë masa për asetet që ka në administrim si dhe për asetet e trashëguara nga ish Komunitat në juridiksion të saj, nëpërmjet strukturave të saj e sidomos sektori i Pyjeve, Kullotave dhe Bordi i Kullimit, për:

- a) të ngritur një komisioni për të kryer inventarizimin kontabël dhe fizik të aseteve, të hartohet pasqyra përmbledhëse për të tre Njësitë Administrative,
- b) të kryer aplikime në ZVRPP Gjirokastër për regjistrimin e tyre,
- c) krijimin e regjistrit kontabël të gjithë aktiveve, që zotëron apo ka në administrim Bashkia me të dhënat përkatëse të çdo aktivi.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Dropull, nuk janë zbatuar plotësisht masat e rekomanduara të rikërkua me shkresën nr. 1015/55 prot., datë 05.04.2016 të Kontrollit të Lartë të Shtetit, duke mos u zbatuar plotësisht 4 masa për shpërblim dëmi në vlerën 2,824,433 lekë.

7.1.Rekomandimi: Nga Bashkia Dropull të merren masa për zbatimin e plotë të masave të rekomanduara dhe të pa realizuara apo në proces zbatimi deri më datën 24.07.2017 të cilat janë dërguar me shkresën nr. 1015/55 prot, datë 05.04.2016 të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe përshkruara në akt verifikimin nr. 1 datë 24.06.2017 “Mbi auditimin e zbatimit të rekomandimeve...”, dorëzuar në zyrën e protokollit të Bashkisë Dropull më datën 24.06.2017.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH* dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga **Titullari i njësisë publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në **vlerën 4,988,342 lekë**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga ish komuna Dropull i Poshtëm janë kryer pagesa për shpenzime të telefonisë dhe të internetit në celular, për ish kryetarin e Komunës, në kundërshtim me specifikimet e miratuara në kategorizimet e nivelit të pagave sipas lidhjeve nr. 1-6, si dhe pikës 11 të VKM nr. 864, datë 23.7.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë, publikë”, në vlerën **82,071 lekë** e cila përbën dëm ekonomik në të ardhurat e ish komunës.

1.1.Rekomandimi: Zyra e Financës në Bashkinë Dropull të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **82,071 lekë**, nga ish kryetari i Komunës Dropull i Poshtëm z. Dh.M. pagesa të kryera për telefonin celular.

Brenda datës 31.12.2017

2. Gjetje nga auditimi: Nga ish komuna Pogon janë kryer pagesa për shpenzime të telefonisë celulare, për ish kryetarin e Komunës, në kundërshtim me specifikimet e miratuara në kategorizimet e nivelit të pagave sipas lidhjeve nr.1-6, si dhe pikës 11 të VKM nr.864, datë 23.7.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë, publikë”, në **vlerën 119,067 lekë** e cila përbën dëm ekonomik në të ardhurat e bashkisë.

2.1.Rekomandimi: Zyra e Financës në Bashkinë Dropull të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **119,067 lekë**, nga ish kryetari i Komunës Pogon z. Th.Q. pagesa të kryera për telefonin celular.

Brenda datës 31.12.2017

3. Gjetje nga auditimi: Nga ish komuna Pogon janë kryer pagesa për shpenzime udhëtimi e dieta për ish Kryetarin e Komunës, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit, i ndryshuar, në **vlerën 9,000 lekë** e cila përben dëm ekonomik në të ardhurat e bashkisë.

3.1.Rekomandimi: Zyra e Financës në Bashkinë Dropull të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **9,000 lekë**, nga ish kryetari i Komunës Pogon z. Th.Q. pagesa të kryera për udhëtim e dieta.

Brenda datës 31.12.2017

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren të punimeve për objektin “**Masa Mbrojtëse te Ura në Fshatin Likomil**”, Bashkia Dropull, rezultuan diferenca në vlerën 122,117 lekë pa tvsh, që i takon punimeve të pakryera. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën për mbikëqyrjen e punimeve lidhur me Autoritetit Kontraktor Bashkia Dropull dhe mbikëqyrësit të punimeve ing. I.L.

4.1.Rekomandimi: Nga Bashkia Dropull të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **122,117 lekë pa tvsh** nga OE “**T..**” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. - prot., datë 11.12.2015 me objekt “Masa Mbrojtëse te Ura në Fshatin Likomil”, Bashkia Dropull, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 31.12.2017

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren të punimeve për objektin “Ndërtimi i Tubacionit të Ujit të Pijshëm Goricë-Terihat-Sofratikë dhe rikonstruksioni i Rrjetit të Fshatit Dervician”, ish-Komuna Dropull i Poshtëm, Dropull, rezultuan diferenca në vlerën **1,678,505 lekë pa tvsh**, që i takojnë punimeve të pakryera. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën për mbikëqyrjen e punimeve lidhur me Autoritetit Kontraktor ish-Komuna Dropull i Poshtëm dhe mbikëqyrësit të punimeve ing. G.M.

5.1.Rekomandimi: Nga Bashkia Dropull të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,678,505 lekë pa tvsh** nga OE “**N...**” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 314 prot., datë 15.05.2013 me objekt “Ndërtimi i Tubacionit të Ujit të Pijshëm Goricë-Terihat-Sofratikë dhe rikonstruksioni i Rrjetit të Fshatit Dervician”, ish-Komuna Dropull i Poshtëm, Dropull, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 31.12.2017

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i taksave dhe tarifave vendore për vitin 2016 u konstatua se nuk janë arkëtuar detyrimet për taksat vendore të subjekteve të biznesit të madh të biznesit të vogël në vlerën totale **574,270 lekë dëm ekonomik, përkatësisht:**

-përlllogaritje jo e saktë dhe mosarkëtim i detyrimit për taksat vendore të subjekteve të biznesit të madh në vlerën 368,820 lekë,

-përlllogaritje jo e saktë dhe mosarkëtim i detyrimit për taksat vendore të subjekteve të biznesit të vogël në vlerën 205,450 lekë,

Veprime këto në shkelje të ligjit nr. 9920, datë 19.04.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

6.1.Rekomandimi: Bashkia Dropull, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **574,270 lekë**, sipas Aneksit nr. 7/1 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 31.12.2017

7. Gjetje nga auditimi: Nga zyra e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, nuk është llogaritur saktë taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja, nuk është kryer përlllogaritja në bazë të çmimit referencë që është kosto mesatare e ndërtimit sipas Entit Kombëtar të Banesave, në shkelje të ligjit nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar neni 46, për 4 subjekte **në vlerën 2,077,807 lekë, dëm ekonomik**, në të ardhurat e buxhetit të Bashkisë.

7.1.Rekomandimi: Bashkia Dropull, Zyra e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin nga 4 persona të vlerës **2,077,807 lekë**, sipas Aneksit nr.8/1 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 31.12.2017

8. Gjetje nga auditimi: Nga Zyra e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, nuk është vepruar për të krahasuar vlerën e punimeve të preventivit me vlerën e punimeve të situacionit, mbi të cilën është përlllogaritur taksa e ndikimit në Infrastrukturë, për lejet e shfrytëzimit të objekteve, ku ka rezultuar diferenca në taksën e ndikimit në infrastrukturë, në shkelje të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar neni 13 dhe Udhëzimit të KM nr.3 datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit, ndryshuar kapitulli II, pika3, **në vlerën 325,505 lekë, vlerë që përbën të ardhur të munguar në Buxhetin e Bashkisë.**

8.1.Rekomandimi: Nga Bashkia Dropull, të merren masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **325,505 lekë**, sipas Aneksit nr.8/2, bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 31.12.2017

C. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Në prokurimin publik me objekt “*Pastrim mbeturinash*” KVO-së me për zgjedhjen e ofertës fituese në kundërshtim me nenet 20, 46, 53, 54 të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, kreu V i VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, llogaritet një efekt negativ në shumën 1,436,472 lekë me TVSH për buxhetin e NjQV ish-Komuna Dropull i Poshtëm, si pasojë e realizimit të shpenzimit në kundërshtim me bazën ligjore.

1.2.Rekomandimi: Nga Bashkisë Dropull të merren masat të analizoj me grup pune të veçantë duke nxjerr shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorimin me efektivitet, ekonomikitet dhe efience të fondeve publike për procedurën e prokurimit me efekte negative në përdorimin e fondeve publike duke vënë theksin në rritjen e vlerës së shtuar nga përdorimi i fondeve publike në shërbim të komunitetit.

D. MASA DISIPLINORE:

D/1. Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së , të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të nenit 58,“llojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2017 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe, nenin 64 shkronjën g, të ligjit nr. 139/2015,datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, **i rekomandojmë** Kryetarit së Bashkisë Dropull, që ti kërkojë Komisionit Disiplinor të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

a)“Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, parashikuar në nenin 58 shkronja “c”, për 4 punonjësit e mëposhtëm:

1.z. L.K. me detyrë specialist në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

Për shkeljet e mëposhtme:

-Për mos llogaritje të saktë të taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja, në bazë të çmimit referencë që është kosto mesatare e ndërtimit sipas Entit Kombëtar të Banesave,në shkelje të ligjit nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar neni 46, **në vlerën 2,077,807 lekë, dëm ekonomik**, në të ardhurat e buxhetit të Bashkisë.

-Për mosveprim për të krahasuar vlerën e punimeve të preventivit me vlerën e punimeve të situacionit, mbi të cilën është përlllogaritur taksa e ndikimit në Infrastrukturë, për lejet e shfrytëzimit të objekteve, ku ka rezultuar diferenca në taksën e ndikimit në infrastrukturë,në shkelje të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar neni 13 dhe Udhëzimit të KM nr.3 datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit, ndryshuar kapitulli II, pika3, **në vlerën 325,505 lekë, me efekt financiar negativ, dëm ekonomik në Buxhetin e Bashkisë.**

2. z. N.P. me detyrë Përgjegjës i Zyrës së Sektorit të Pyjeve, Kullotave Bordit të Kullimit.

Për shkeljet e mëposhtme:

-Për mosveprim, për të lidhur kontratë qiraje me subjektet private të cilat janë pajisur me leje minerare, të miratuara nga Ministria e Energjetikës dhe Industrisë, për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore ku ushtrojnë aktivitetin e tyre për qëllime biznesi, në shkelje të VKM nr. 391, datë 21.06.2006, të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, lidhja nr. 2, pikat 6, 11 dhe 12, në vlerën **37,329,600 lekë**, për 7 raste (subjekte) të cilat përbëjnë efekt financiar negativ, të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë Dropull.

-Për mosveprim,për të kryer paksimin dhe heqjen nga fondi pyjor dhe fondi kullosor, të sipërfaqeve pyjore e kullosore në të cilat ushtrohet veprimtaria e shfrytëzimit të aktiviteteve private nga subjektet e pajisura me leje minerare në territorin në administrim të bashkisë. Nuk është dërguar shkresë në formë kërkesë në Ministrinë e Mjedisit, për plotësimin e dokumentacionit teknik dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqeve prej 22,2 ha nga fondi pyjor, nuk janë ndjekur procedurat për heqjen dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor, në kundërshtim me nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 “Për Fondin Kullosor”, pikat 3, 7,

7, 9, 10, 11 dhe 12, VKM nr. 1353, datë 10.10. 2008 “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, i ndryshuar me VKM nr. 434, datë 08.06.2016, VKM nr. 1374, datë 10.10. 2008 “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor”, i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2016

3. znj. A.K. me detyrë N/Kryetare e Bashkisë, në cilësinë e Kryetares së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave,

4. znj. Th.P. me detyrë Drejtoresë e Drejtorisë Ekonomike, në cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave,

Për shkeljet e mëposhtme:

-Për mangësi në drejtim të klasifikimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në tender. Kjo mangësi është vërejtur edhe në disa raste në drejtim të kualifikimit të operatorit ekonomik të shpallur fitues, ku nga auditimi i ofertave të paraqitura në formatin elektronik rezultuan me mangësi dhe si rrjedhojë duhej të ishin skualifikuar. Të tilla ishin operatorët ekonomikë si më poshtë:

-Shoqëria “T...” sh.p.k. në tenderin “Masa mbrojtëse hidroteknike te ura e fshatit Likomil”.

-Shoqëria “A...” sh.p.k. në tenderin “Ujësjiellësi i jashtëm i Dropullit nga burimi i Manxifes”.

-Shoqëria “O...” sh.p.k. me tender “Rikonstruksion rruga e brendshme Sopik”

Shoqëria “T...” sh.p.k. në tenderin “Kanali ushqyes i rezervuarit të Pepelit Gjirokastër dhe pastrim kanali vaditës i Pepelit nga pecalludha, deri në repartin Bularat 4200”.

H. TË TJERA.

Ky auditim nuk u evadua në përputhje me afatet e përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Kontrollit të Lartë të Shtetit, pasi për shkak të konstatimeve të një sërë mangësive dhe pasaktësive në procesin e vlerësimit të objektivitetit të auditimit dhe vlerësimit si një punë e dobët audituese nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, me Vendimin e Ndërmjetëm nr. 113, datë 19.09.2017, u iniciua Kontrolli i Cilësisë së kësaj dosje dhe plotësimi i gjetjeve dhe rekomandimeve nga një grup i dytë auditimi.

Nga Kontrolli i Cilësisë i kësaj dosje auditimi në referencë të kërkesave të Vendimit të Ndërmjetëm nr.113, datë 19.09.2017, rezultoi se nuk ishin trajtuar në mënyrë të detajuar ligjshmëria në lidhje me përlllogaritjet e fondeve limit, kriteret e vendosura në to si dhe vlerësimet e KVO-ve në lidhje me kualifikimin apo s’kualifikimin e OE pjesëmarrës në procedurat e prokurimeve publike të cilat janë zhvilluar nga Bashkia Dropull. Konstatohet mungesë profesionalizmi në auditimin e procedurave të prokurimit, nga audituesi Z. V. P. i cili ka patur për të mbuluar me auditim këtë pikë të programit.

Nga grupi i ngarkuar për Kontrollin e Cilësisë, sipas Vendimit të Ndërmjetëm nr. 113, datë 19.09.2017 janë audituar 16 procedura prokurimi. Në shumicën e procedurave të prokurimit të verifikuara, nga ana e grupit të auditimit nuk është trajtuar ligjshmëria e procedurave të prokurimit, por janë përshkruar të dhëna kronologjike në lidhje me to. Ky fakt si dhe ngarkesa e anëtarëve të grupit të kontrollit të cilësisë, janë arsytet që ky proces i kontrollit të cilësisë tejkaloi afatet e përcaktuara në Vendimin e Ndërmjetëm nr.113 datë 19.09.2017.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore.

BUJAR LESKAJ

K R Y E T A R

NË MUNGESË DHE ME URDHËR EMËRTIMI

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Manjola NAÇO